

Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

Shtëpia Botuese “SALTA BOOKS” SHPK

Në këtë Statut:

- “**Ligji**” është Ligji Nr. 9901, data 14. 04. 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” me ndryshimet që i bëhen herë pas here;
- “**QKB**” do të thotë “Qendra Kombëtare e Biznesit”.
- “**Statuti**” është ky statut i Shoqërisë;
- “**Shoqëria**” është shoqëri tregtare Shtëpia Botuese “SALTA BOOKS” SHPK

KREU 1 THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 25 Gusht 2022 (Dymije e njezetedy), Une themeluesi, krijoj një shoqeri me per gjegjesi te kufizuar me emrin Shtëpia Botuese “SALTA BOOKS” SHPK

Themeluesi dhe Ortaku i vetem i Shoqerise është:

Artur Bego, lindur ne Patos, Shqiperi, me 19. 12. 1970, banues ne Rruga: Rruga "Kadri Roshi", Ndërtesa Nr. 13, Hyrja 5, Apartamenti 41, Yzberish, Kashar, 1050, Tiranë (Shqipëri), me numer personal H01219023K, dhe numer leternjoftimi 037013612, leshuar nga Ministria e Punave te Brendshme me: 08. 03. 2021.

Neni 2

Objekti

Shtëpi botuese. Botimi dhe shtypshkrimi i veprave të ndryshme, librave, revistave, gazetave, materialeve letrare, artistike, si edhe parashkollarë, shkollore, universitare, akademike, shkencore, për diasporën etj. Ato do të kenë forma të ndryshme duke filluar nga forma më tradicionale e letrës së shtypur deri në format moderne elektronike. Aktiviteti i Shoqërisë do të përfshijë çdo veprim që do të lidhet me përgatitjen e redaktimeve, botimeve, reklamave dhe shpërndarjen e transportin e veprave të botuara. Botimet do të kenë treg shpërndarje të gjerë brenda dhe jashtë vendit si edhe shitje on-line të çdo botimi në forme letre dhe elektronike.

Objekt i Shoqërisë do të jenë edhe shtypshkrimet e karakterit sekret me elemente sigurie, si edhe çdo lloji dokumenti zyrtar apo jozyrtar.

Gjithashtu, Shoqëria do të merret me shërbime si: Hartimin, zbatimin, organizimin dhe monitorimin e projekteve, bashkëpunimi ose jo, me natyrë letrare, artistike, kulturore,

kinematografike, sportive, ekonomike, juridike, komunikimi, sociale, informatike, etj; Ndërmjetësimin dhe organizimin e konferencave, seminareve, dhe aktiviteteve të ndryshme, letrare, artistike e kulturore; Konceptimin, organizimin, menaxhimin, marketingun, promovimin e fushatave e eveneve të ndryshme; Marrëdhënieve me publikun, spoteve publicitare në fushën e desingit, publikimeve, reklamave dhe promocionit.

Objekt i aktivitetit të Shoqërisë do të jenë edhe eksport-importi, transporti i materialeve të ndryshme, shitje me shumicë dhe me pakicë, tregtim i të gjitha pajisjeve dhe materialeve tipografike dhe shtypshkronje, kancelari me shumicë dhe pakicë, logime të kancelarive dhe produkteve industriale dhe tekstile, plastifikim dhe llakim letre, etj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pakufizuar.

Neni 4

Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga: Rruga "Kadri Roshi", Ndërtesa Nr. 13, Hyrja 5, Apartamenti 41, Yzberish, Kashar, 1050, Tiranë (Shqipëri)

KREU 2 KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Lekë (Njëqind Lekë) i përbërë nga 1 (një) kuotë.
2. I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortaku si ne vijim:
Z. Artur Bego, ka nënshkruar një kuotë me vlerë 100 Lekë (Njëqind Lekë) që përbën 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
Ortaku ka paguar vlerën e kapitalit themeltar.
3. Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë statut dhe atyre të parashikuara nga ligji shqiptar.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kereses se Administratorit. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen për ndryshimine statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te Shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet çdo menyre te parashikuar me ligj. Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne Statut.

KREU 3 ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organ i Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve eshtë organi i vetëm vendimmarrës i Shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve miraton çdo ndryshim të Statutit sipas modalitetave te përaktuara në Ligj.

Asambleja e Ortakëve eshtë pergjegjese per marrjen e vendimeve per Shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorin/administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- g) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise;
- h) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimitarise;
- i) Zmadhim dhe zvogelimin e kapitalit;
- j) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe be procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- l) Riorganizim dhe prishjen e shoqerise;
- m) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- n) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo Statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e Ortakeve ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete:

Administratori i Shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Ortakeve.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Ortakeve

Asambleja e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike ne adresat e njoftuara nga ortaket. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur Asambleja e Ortakeve nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur Asambleja e Ortakeve duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se giysmen e numrit total te votave, jane pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te Ligjit. Nese Asambleja e Ortakeve nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit, te permendur me lart, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e Ortakeve vundos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve vundos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
- b) emerimin e shkarkimin e administratorin/administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve;
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratore;
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Çdo Ndryshim i Statutit duhet te depozitohet prane QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skeden e Shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejtene votes nese asambleja e perjithshme merr vendim për:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqeria

d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga një perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jetë ne te njejtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e Ortakeve emeron një Administrator te Shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 (pese) vjet me te drejtë riperteritje. Emerimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i Shoqerise per një afat 5 vjecar:
Te dhenat e identifikimit:

- **Artur Bego**, shtetas shqiptar, lindur ne Patos, Shqiperi, me 19. 12. 1970, me numer personal H01219023K

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare te Shoqërisë , duke zbatuar politikat tregtare , të vendoșura nga Asambleja e Ortakëve;
- b) përfaqësojë Shoqërisë
- c) kujdeset përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqerise
- d) përgatisë dhe nënshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve , i paraqet këto dokumente përparrë Asamblesë së Ortakëve përmiratim;
- e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqerise;
- f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë , siç parashikohet në ligjin përmes QKB .
- g) raporton përparrë Asamblesë së Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinë Shoqërisë tregtare ;
- h) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Ortakëve në rastet kur:

-Sipas bilancit viator apo raporteve të ndërmjetme financiare , rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim .

-Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive , të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përmes qind të aseteve të Shoqërisë , që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara

-Shoqëria , brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj , propozon të blejë nga një ortak pasuri , që kanë vlerë më të lartë se 5 përmes qind të aseteve të Shoqërisë , që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara .

Asambleja e Ortakëve mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme . Paditë që lidhen me shpërbimin e Administratorit në buzë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitet e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht , ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë , i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen , për të përballuar në menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse . Përveç sa është parashikuar në dispozitat e per gjithshme të detyrimit të besnikërisë , sipas neneve 14 , 15 , 17 e 18 të ligjit . Administratori detyrohet

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërsë , duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statur vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet , për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit , prezent apo të mundshem , interesave personale me ata të Shoqërisë ;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm .

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë , atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara , të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë.
a) me vendim të Asamblese se Ortakeve;

- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast , Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar I apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim”. Nese Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i Shoqërisë, bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet , bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë se Ortakëve, në perputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit .

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e Ligjit, Kodit Civil dhe cfaredo ligii tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statusi, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve do te jete Kompetente Giykata Shqiptare.

Neni 22


Ky Statut përpilohet në 4(katër) kopje originale me vlerë të njëjtë ligjore në gjuhën shqipe. Statuti mbylljet me 22(njëzet e dy) nene.

Ky Statut do te shërbej gjithashtu si Akt i Themelimit te shoqërisë se re dhe do te regjistrohet ne Regjistrin Tregtar me depozitim e këtij dokumenti te nënshkruar.

Autorizohet Administratori i shoqerise te kryeje gjithe veprimet e nevojshme per regjistrimin e shoqerise ne QKB.

ORTAKU THEMELUES

ARTUR BEGO


A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Artur Bego" followed by the date "22.03.22".